Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/*
*Ministarstvo Obrazovanja i Nauke,Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

Dokument konsultimi

Përmbledhje e shkurtër rreth draftit të Koncept dokument për Ligjin e Arsimit dhe Aftësimit Profesional në Republikën e Kosovës

**Commented [KB1]:** Më poshtë fq.3 koncept dokumenti ka tjeter emertim "për fushën e qeverisjes dhe menaxhimit të arsimit dhe aftësimit profesional në Republikën e Kosovës". Keto dallojne ne thelb.

Ky Koncept dokument është hartuar në zbatim të Vendimit të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit Nr. 2-3316, dt. 01.11.2023, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta zyrtare nr. 70/01 mars 2019), si dhe nenit 8, paragrafi 5 i Rregullores nr. 13/1013 për shërbimin ligjor qeveritar.

Qëllimi i Koncept dokumenti është harmonizimi më i mirë i arsimit me nevojat e tregut të punës si dhe përmirësimi i qeverisjes, financimit dhe sistemit të menaxhimit të informatave të arsimit dhe aftësimit profesional dhe arsimit për të rritur, konsolidimi i mekanizmave për sigurim të cilësisë në nivel qendror dhe në nivel të IAAP-ve, harmonizimi i kualifikimeve në arsimin dhe aftësimit profesional, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe sigurimi i mundësive për realizimin e mësimit praktik dhe funksionalizimi i shërbimeve të këshillimit dhe orientimit në karrierë.

## *Qëllimi i konsultimit*

Gjatë hartimit të këtij Koncept dokumenti janë mbajtur një varg punëtorish me anëtaret e Grupit punues të emëruar me vendim të Sekretares së Përgjithshme.

Nga procesi i konsultimit presim të marrim propozime dhe opinionet nga të gjitha palët e interesit, nw funksion të plotësimit dhe avancimit të mëtejmë të draft-dokumentit, duke u siguruar që ky Koncept dokument ta  arrij qëllimin që ka.

Ky koncept dokument përbën një fillesë të zbatimit të një reforme gjithëpërfshirëse në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional, që vjen si nevojë e zhvillimeve në ekonominë e vendit përkatësisht tregut të punës, si dhe Raportin për Republikën e Kosovës të Komisionit Evropian të BE-së.

Data e fillimit: 24.04.2024

**Data e përfundimit: 17.05.2024**

***Çka duhet të përmbajnë komentet***

**Emri i personit/organizatës që jep komente: Kushtrim Bajrami, në cilësi të njohësit të fushës së arsimit dhe aftësimit profesional**

**Fushat kryesore të veprimit të organizatës:**

**Informatat e kontaktit të organizatës (adresa, e-mail, telefoni):**
**kushtrim.bajrami@gmail.com**

**Data e dërgimit të komenteve: 15.05.2024**

**Komentet:**

Konceptdokument për fushën e qeverisjes dhe menaxhimit të arsimit dhe aftësimit profesional në Republikën e Kosovës

Përgatitur nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

Departamenti i arsimit dhe aftësimit profesional

**Commented [KB2]:** Koment i pergjithshem: Te gjitha objektivat e kesaj nisme jane perqendruar ne rishikimin e kornizes institucionale dhe ligjore. Nuk eshte perfshire fare nje nder prioritet kyqe te Qeverise - arsimi dual dhe modalitet e zbatimit te tij.

**Commented [KB3]:** Koment i pergjithshem: Rritja e autonomise dhe fuqizimi i meanxhmetit te shkollave profesionale nuk eshte paraqitur fare ceshtje qe synon te trajtohet ne kete reforme, perkunder qe kjo ceshtje eshte shume e rendesishme.

## Përmbajtja

Përmbledhje e konceptdokumentit ... 5

Hyrje ... 8

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit ... 9

**Përshkrimi i kuadrit ligjor ekzistues** ... 16

Kapitulli 2: Objektivat ... 26

Kapitulli 3: Opsionet ... 27

Kapitulli 3.1: Asnjë ndryshim ligjor, por vetëm intervenime riparuese në nivel të dokumenteve strategjive përkatëse të arsimit dhe aftësimit profesional (Opsioni asnjë ndryshim) ... 28

Kapitulli 3.2: Adresimi i reformës përmes plotësim-ndryshimeve të ligjeve individuale të fushës së arsimit dhe aftësimit profesional dhe të KKK-së (Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit) ... 29

Kapitulli 3.3: Adresimi i reformës së strukturës institucionale të arsimit dhe aftësimit profesional dhe KKK-së në Republikën e Kosovës përmes nxjerrjes së një ligji kodifikues (Opsioni i tretë) ... **Error! Bookmark not defined.**

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme ... 32

Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave ... 34

Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi ... 34

Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve ... 35

Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme ... 36

Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm ... 46

Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin ... 46

Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik ... 1

Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore ... 5

Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore ... 10

Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore ... 13

## Përmbledhje e konceptdokumentit

| **Informacion i përgjithshëm** | |
|---|---|
| Titulli | Konceptdokument për fushën e qeverisjes dhe menaxhimit të arsimit dhe aftësimit profesional në Republikën e Kosovës |
| Ministria bartëse | Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) |
| Personi kontaktues | Lah Nitaj, drejtor i departamentit të arsimit dhe aftësimit profesional |
| PKZH | Qëllimi strategjik 4.3.: Harmonizimi më i mirë i arsimit me nevojat e tregut të punës<br><br>Masa 4.3.1. Përmirësimi i qeverisjes, financimit dhe sistemit të menaxhimit të informatave të arsimit dhe aftësimit profesional dhe arsimit për të rritur<br><br>Masa 4.3.2. Konsolidimi i mekanizmave për sigurim të cilësisë në nivel qendror dhe në nivel të IAAP-ve<br><br>Masa 4.3.3 Harmonizimi i kualifikimeve në arsimin dhe aftësimit profesional, në përputhje me kërkesat e tregut të punës<br><br>Masa 4.3.4. Sigurimi i mundësive për realizimin e mësimit praktik dhe funksionalizimi i shërbimeve të këshillimit dhe orientimit në karrierë |
| Prioriteti strategjik | Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2030<br><br>Objektivi 4.3.: Harmonizimi më i mirë i arsimit me nevojat e tregut të punës<br><br>Masa 4.3.1. Përmirësimi i qeverisjes, financimit dhe sistemit të menaxhimit të informatave të arsimit dhe aftësimit profesional dhe arsimit për të rritur<br><br>Masa 4.3.2. Konsolidimi i mekanizmave për sigurim të cilësisë në nivel qendror dhe në nivel të IAAP-ve<br><br>Masa 4.3.3 Harmonizimi i kualifikimeve në arsimin dhe aftësimit profesional, në përputhje me kërkesat e tregut të punës<br><br>Masa 4.3.4. Sigurimi i mundësive për realizimin e mësimit praktik dhe funksionalizimi i shërbimeve të këshillimit dhe orientimit në karrierë<br><br>Strategjia e Arsimit 2022-2026:<br><br>Objektivi Strategjik 3: Harmonizimi i arsimit dhe aftësimit profesional me zhvillimet |

| | |
|---|---|
| | dinamike të teknologjisë dhe tregut të punës, në funksion të mësimit gjatë gjithë jetës |

| **Vendimi** | |
|---|---|
| Çështja kryesore | Konsolidimi dhe rritja e efektivitetit të strukturës institucionale në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional |
| Përmbledhja e konsultimeve | // |
| | |
| Opsioni i propozuar | **Opsioni i tretë (Adresimi i reformës së strukturës institucionale të arsimit dhe aftësimit profesional dhe KKK-së në Republikën e Kosovës përmes plotësim-ndryshimeve të ligjeve individuale)** |

| **Ndikimet kryesore të pritshme** | |
|---|---|
| Ndikimet buxhetore | Zbatimi i politikës pritet të ketë impakt buxhetor; do të ulen shpenzimet fikse për mbajtjen e dy agjencive, në një të vetme. Gjithashtu, do të ulet barra administrative që ka një kosto fikse relativisht të lartë. |
| Ndikimet ekonomike | Zbatimi i politikës do të ketë ndikim pozitiv në ekonominë e vendit. Ai do të mundësojë një ndërlidhje më të mirë të arsimit dhe aftësimit profesional me nevojat e tregut të punës dhe industrive prodhuese e shërbyese në Kosovë. Një rritje e harmonizimit ndërmjet të dyjave do të rrisë eficiencën e parasë publike, të rrisë produktivitetin e ekonomisë vendore dhe të vet sistemit arsimor në përgjithësi. Gjithashtu, fuzionimi i agjencive do kontribuojë në komplementimin e shërbimeve të të dyja institucioneve paraprake ne një të vetëm, faktor i cili do ndikojë në zhvillimin e fuqisë punëtore. |
| Ndikimet sociale | Zbatimi i politikës nuk pritet të ketë ndonjë ndikim negativ social. Përkundrazi, konceptdokumenti i ndihmon politikës së punësimit të plotë, rritjes së aftësisë së punësueshmërisë të kategorive shoqërore që kanë mungesë kualifikimi, atyre që ju nevojitet riaftësimi për mbajtjen e vendit të punës apo ngritjen/promovimin në vendin e punës, etj. |
| Ndikimet në të drejtat themelore | Zbatimi i politikës nuk do të ketë ndonjë ndikim negativ në të drejtat themelore. Ai, në anën tjetër, do ndihmojë në përmbushjen më efektive të obligimeve pozitive të shtetit në raport me të drejtën në arsim të individëve. |

**Commented [KB4]:** Si do te ndodh kjo, cilat shpenzime fikse do te ulen? Perkundrazi, nese vertete synohet fuqizimi i Agjencise per AAP me mandat dhe funksione te reja, atehere do te kerkohen kapacitete shtese njerezore, financiare, institucionale dhe per te gjitha keto duhet buxhet shtese. Kjo nuk qendron dhe nuk ka kuptim per aq kohe sa objektivi i kesaj nisme eshte fuqizimi i agjencise.

| | |
|---|---|
| Ndikimet mjedisore | Zbatimi i politikës nuk do të ketë ndonjë ndikim negativ mjedisor. |
| Ndikimet ndërsektoriale | Zbatimi i politikës do ta unifikojë politikën arsimore me atë të nxitjes dhe rritjes së konkurrueshmërisë në tregun e punës dhe të specializimit të industrive prodhuese e shërbyese në tregun e Kosovës. |
| Ngarkesat administrative për kompanitë | Zbatimi i politikës nuk do të rezultojë në ndonjë ngarkesë të re administrative, përkundrazi ai synon t'i lehtësojë ngarkesat e tepërta që prodhohen për shkak të procedurave burokratike dhe ndërlikimit të mekanizmit institucional. |
| Testi i NVM-ve | Zbatimi i politikës nuk rezulton të ketë ndonjë ndikim negativ në testin e NVM-ve. |

| **Hapat e ardhshëm** | |
|---|---|
| Afatshkurtër | 1. Hartimi dhe miratimi i ligjit të ri |
| Afatmesëm | 1. Riorganizimi i Agjencisë për Arsimin dhe Aftësimit Profesional dhe Autoritetit Kombëtar i Kualifikimit<br>2. Funksionalizimi i strukturës së re të arsimit dhe aftësimit profesional dhe fillim-zbatimi i politikave të reja |

## Hyrje

*Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për konceptdokumentin*

| | |
|---|---|
| Titulli | Konceptdokument për fushën e qeverisjes dhe menaxhimit të arsimit dhe aftësimit profesional në Republikën e Kosovës |
| Ministria bartëse | Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI); Departamenti i Arsimit Profesional |
| Personi kontaktues | Lah Nitaj, drejtor i departamentit të arsimit dhe aftësimit profesional |
| PKZH | 4.3. Harmonizimi më i mirë i arsimit me nevojat e tregut të punës<br>4.3.1. Përmirësimi i qeverisjes, financimit dhe sistemit të menaxhimit të informatave të arsimit dhe aftësimit profesional dhe arsimit për të rritur |
| Prioriteti strategjik | Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2030<br>Objektivi 5: Treg i punës gjithëpërfshirës, punësim më i lartë dhe i denjë<br>Nënobjektivi 1: Zhvillimi i aftësive dhe zgjerimi i shërbimeve të punësimit; |
| Grupi punues | Anëtarët e grupit punues janë:<br>1. Lah Nitaj, drejtor i dep. të arsimit dhe aftësimit profesional kryesues;<br>2. Valbona Fetiu-Mjeku, departamenti i arsimit profesional/MASHTI, zv. kryesues<br>3. Majlinda Rizvanolli, Kabineti i Ministres/MASHTI, anëtare<br>4. Ryve Prekorogja, departamenti i arsimit profesional/MASHTI, anëtare<br>5. Veton Alihajdari, departamenti i arsimit profesional/MASHTI, anëtar<br>6. Rina Ponosheci, departamenti i arsimit profesional/MASHTI, anëtare<br>7. Agim Krasniqi, departamenti i arsimit profesional/MASHTI, anëtar<br>8. Aferdita Jaha, departamenti i arsimit profesional/MASHTI, anëtare<br>9. Fehmi Zylfiu, departamenti i arsimit profesional/MASHTI, anëtar<br>10. Isni Kryeziu, departamenti i arsimit profesional/MASHTI, anëtar<br>11. Fikrije Zymberi, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, anëtare<br>12. Arbër Salihu, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, anëtar<br>13. Besnike Mehmeti, zyra ligjore e ZKM, anëtare<br>14. Mirlinda Lushaku, sekretariati koordinues i Qeverisë - ZKM, anëtare<br>15. Mevlude Shamolli, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, anëtare<br>16. Përfaqësues nga GIZ, anëtar<br>17. Anton Gojani, projekti ALLED2, anëtar<br>18. Kolegjiumi i Drejtorive Komunale të Arsimit |

**Commented [KB5]:** Fatkeqsisht, sektori privat nuk qenka fare i perfshire/konsultuar ne pergatitjen e ketij dokumenti. Ngjajshem edhe mungesa e perfshirjes se perfaqesuesve nga shkollat profesonale.

| Informata shtesë | Ky konceptdokument përbën një fillesë të zbatimit të një reforme gjithëpërfshirëse në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional, që vjen si nevojë e zhvillimeve në ekonominë e vendit përkatësisht tregut të punës, si dhe Raportin për Republikën e Kosovës të Komisionit Evropian të BE-së. |
|---|---|

## Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

Politika publike në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional në Republikën e Kosovës përbën një nga degët më të rëndësishme të planit qeveritar, të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2030, të Strategjisë së Arsimit 2022-2026, dhe të vet legjislacionit në fuqi në fushën e arsimit parauniversitar në përgjithësi. Harmonizimi i programeve mësimore në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e tregut të punës, zhvillimit të industrive kompetitive dhe në përgjithësi ndjekja e trendeve të globalizimit në kuptim të dijes dhe shkathtësive të nevojshme për t'i përmbushur nevojat e punëdhënësit përbëjnë të gjitha komponentët e rëndësishëm të reformave strukturore në Republikën e Kosovës.[1]

Një dimension shumë i rëndësishëm në këtë kuadër reformash është para së gjithash reformimi i strukturës institucionale në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional. Mungesa e një reforme të tillë po e bën të pamundshme qartësimin e linjave të përgjegjësisë, thjeshtësimin e planifikimit strategjik, krijimin e një qarku të qartë të vendimmarrjes për të gjitha çështjet e lidhura me zbatimin e legjislacionit dhe gjithashtu rritjen e mbajtjes së përgjegjësisë të bartësve institucional në këtë fushë. Struktura institucionale momentale është shumë komplekse, e shtrirë në shumë shkallë vendimmarrëse, e fragmentuar në një format jo-proporcional në raport me një qëllim legjitim dhe mbi të gjitha e shpërqendruar në disa drejtime jo shumë të qarta përgjegjësish. Kompleksitetit të tillë institucional i kontribuon edhe mungesa e konsolidimit të mekanizmave të brendshëm për sigurimin e cilësisë në nivelin mikro (të IAAP-ve): në Strategjinë e Arsimit theksohet që mekanizmat për sigurimin e cilësisë në nivelin e sistemit nuk janë të definuar. Si rrjedhojë, mungon monitorimi sistematik i sistemit të arsimit dhe aftësimit profesional dhe raportimi i rregullt mbi cilësinë dhe zhvillimin, që do të informonte dhe lehtësonte hartimin dhe planifikimin e politikave strategjike. Prandaj, mund të konkludohet që mungesa e një kuadri të tillë institucional që do të mundësonte thjeshtësimin, konsolidimin dhe rritjen e efektivitetit të strukturës institucionale në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional po pamundëson zbatimin e një reforme holistike në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional. Siç është aktualisht, ka mungesë serioze të një qarku llogaridhënës ndaj institucioneve qendrore, pjesëmarrësve të tregut/industrive, përfituesit fundor, komunitetit të të diplomuarve, etj. sa i përket rezultateve të të diplomuarve në tregun e punës. Kjo gjithashtu shoqërohet me një barrë të lartë administrative, e cila do të zvogëlohet përmes parashikimit të digjitalizimit aty ku është e mundur.

Arsimi dhe aftësimi profesional, nuk i aftëson dhe përgatitë në mënyrë të duhur nxënësit për të hyrë në tregun e punës pas përfundimit të shkollimit të mesëm profesional, kjo për shkak se AAP ballafaqohet me probleme të shumta. Kualifikimet që ofrohen në shkollat profesionale nuk janë të bazuara mbi nevojat e tregut të punës, standardet e profesionit mungojnë për shumë profile, kurrikula nuk është e përditësuar ndërsa vendimet për hapjen e profileve të caktuara merren pa ndonjë analizë të mirëfilltë të nevojave të

[1] Një numër i madh i të papunëve, sic tregon tabela nr. 1, i takojnë kategorisë së qytetarëve që nuk kanë asnjë kualifikim: një spektër i rëndësishëm për tu targetuar në kuptim të politikës së arsimit dhe aftësimit profesional.



**Commented [KB6]:** Nuk eshte e qarte cili eshte problemi me strukturen institucionale te AAP. Do te duhej te kishte nje elaborim te ketij problemi ashtu sic kerkohet nga titulli i ketij kapitulli. Per me teper, do te duhej te sqarohet cilat linja te pergjegjesise nuk jane te qarta, pse vleresohet qe planifikimi strategjik nuk qenka i thjeshtesuar - cka e ben ate te komplikuar. Cka konkretisht nuk eshte duke funksionuar?

**Commented [KB7]:** Serish, po vijm ne konluzion pa e shtjelluar kete fillimisht. Ky konkluzion mendoj qe duhet te mbeshtetet ne argumente.

**Commented [KB8]:** Atehere te referencohet kjo ne fusnote.

**Commented [KB9]:** Pse ndodh kjo? A ka dispozita ligjore qe e pamundesojne llogaridhenien? Mendoj qe kjo eshte ceshtje e kapaciteteve dhe nuk nderlidhet me ndonje deformim apo mangesi ligjore.

**Commented [KB10]:** Ne cka konkretisht reflektohet kjo si barre administrative?

tregut të punës. Probleme tjera që ndërlidhën me shkollat e mesme profesionale janë mosbashkëpunimi i duhur me bizneset, mospërshtatja e mjaftueshme me tregun e punës, infrastrukturë dhe pajisje jo të mjaftueshme, mungesë të laboratorëve e punëtorive, të mësimit praktik dhe mësimit në vendin e punës, mungesë të materialeve mësimore, si dhe mungesë të shërbimeve të orientimit dhe këshillimit në karrierë.

**Commented [KB11]:** Dakord keto jane sfidat dhe dobesite e sistemit tone te AAP. Megjithate, si nderlidhen keto me legjislacion? A paraqesin keto probleme qe mund te zgjidhen permes nderhyrjeve ne legjislacion?

Formula aktuale e financimit të AAP-së, nuk i përkrahë kërkesat dhe nevojat e IAAP-ve pasi që kjo formule bazohet në ndarjen e buxhetit për kokë nxënësi, ndërsa nuk merr për bazë nevojat e profileve, siç janë, realizimi i praktikës profesionale, pajisjet, lëndën e parë, trajnimet, sigurimin aksidental të nxënësve, transportin për realizim të praktikës etj. Ky është problem i theksuar që ndikon në performancë dhe sigurim të cilësisë në IAAP.

Sigurimi i cilësisë në AAP është problematikë në vete, ndonëse kemi institucione përgjegjëse për zbatim të sigurimit të cilësisë, mungojnë hallkat dhe konsolidimi i mekanizmave për zbatim të politikave, që lidhen me inspektimin, monitorimin dhe vlerësimin në sistemin e IAAP-ve. Pra, nuk kemi qasje sistemore dhe gjithëpërfshirëse të mekanizmave për sigurim të cilësisë e cila do të ndikonte direkt në performancën e IAAP-ve. Menaxhimi i cilësisë në nivel të shkollave profesionale dhe në nivel të sistemit nuk është funksional dhe efikas në monitorimin e cilësisë, identifikimin e prioriteteve të intervenimit për përmirësim të cilësisë dhe në realizimin e tyre. Korniza ligjore ekzistuese nuk rregullon gjurmimin e të diplomuarve të arsimit dhe aftësimit profesional si masë me rëndësi për monitorim dhe sigurim të cilësisë. Rrjedhimisht mungojnë edhe të dhënat e punësimit të të diplomuarve dhe përputhshmërisë së aftësive të tyre me kërkesat e tregut të punës. Kosova ende nuk ka arritur të zhvillojë një metodologji të standardizuar për hulumtimin e tregut të punës dhe për parashikimin e nevojave të tregut të punës (Strategjia Arsimit 2022-2026), e aq më pak të gjurmimit të trajektoreve të ndryshme të karrierës së të diplomuarve të AAP-së fillestare dhe/apo të vazhdueshme.[2]

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve është indikator tjetër tejet i rëndësishëm që ndikon në mësimdhënie cilësore, por adresimi i nevojave për trajnime adekuate dhe të nevojshme është problem me të cilin ballafaqohen mësimdhënësit e IAAP-ve. Mungojnë udhëzues praktik për identifikimin e nevojave, planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë, të cilat lidhen me zbatimin e kurrikulës, realizimin e mësimit praktik, hartimin e materialeve mësimore, aplikimin e metodave inovative të mësimdhënies.

**Commented [KB12]:** Zhvillimi i udhezuesve praktik, programet per ZHPM, materialet mesimore, metodat inovative te mesimdhenesve as nuk pengohen te zhvllohen nga legjislacioni aktual, e as nuk zhvillohen permes legjislacionit te ri.

[2] Mungesa e qartësisë në lidhje me procedurën për zbatimin e funksioneve të ndryshme siç janë vlerësimi i nevojave dhe planifikimi i programeve të kualifikimit të ofruara nga institucionet publike; planifikimi i numrit të nxënësve që do të regjistrohen në profile të ndryshme kualifikimi; nisja e procesit për hartimin e kurrikulës/programeve të kualifikimit të ofruara nga IAAP-të; vlerësimi i performancës nga Inspektorati i Arsimit; dhe vlerësimi i performancës së sistemit të arsimit dhe aftësimit profesional.

| Tabela 2: Papunësia e regjistruar sipas kualifikimeve | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Niveli i kualifikimeve | Papunësia | (%) | Ndryshimi te 2019 | Femër | Meshkuj |
| Pa kualifikuar | 83,317 | 49.3% | 356.3% | 38,880 | 44,437 |
| Klasët I –IX (Shkolla fillore) | 31,068 | 18.4% | 80.7% | 13,126 | 17,942 |
| Arsim i mesëm profesional | 31,987 | 18.9% | 57.7% | 11,353 | 20,634 |
| Shkollë e mesme gjimnaz | 10,579 | 6.3% | 61.4% | 4,709 | 5,870 |
| Bachelor | 11,069 | 6.6% | 41.3% | 7,075 | 3,994 |
| Master | 960 | 0.6% | 42.6% | 558 | 402 |
| Doc. i Shkencave | - | - | - | - | - |
| Total | 168,980 | 100% | 138.7% | 75,701 | 93,279 |

Burimi: T*ë dhënat administrative të punësimit (MFPT, APRK, 2022)*

**Commented [KB13]:** Kjo eshte tabela 1 ne dokument - duhet permiresuar numri. Megjithate, si po nderlidhet kjo tabele me permbajten ne kapitullin e perkufizimit te problemit?

*Figura 2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore*

| **Dokument i politikave, ligj ose akti nënligjor** | **Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare** | **Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim** | **Roli dhe detyrat e institucionit(-eve)** |
|---|---|---|---|
| **Ligji për arsimin parauniversitar** (nr. 04/L-032) | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770 | Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit | Ministria mban përgjegjësinë kryesore për planifikimin, caktimin e standardeve dhe sigurimin e cilësisë së sistemit të arsimit parauniversitar, si dhe ka detyrat e përgjithshme që:<br>✓ të zhvillojë politika, hartojë dhe zbatojë legjislacionin për zhvillimin e arsimit dhe aftësimit parauniversitar;<br>✓ të përcaktojë rezultatet e niveleve të ndryshme të arsimit dhe aftësimit parauniversitar si dhe të japë kualifikime, ose të autorizojë dhënien e tyre, për të gjithë ata që me sukses i përfundojnë programet parauniversitare sipas niveleve përkatëse të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve;<br>✓ të promovojë sistem jo diskriminues, të arsimit në të cilin respektohen të drejtat e secilit person për arsim dhe aftësim, si dhe ofrohen mundësi të barabarta për arsim cilësor;<br>✓ të promovojë mbrojtjen e grupeve të ndjeshme në kuadër të sistemit të arsimit dhe aftësimit; të sigurojë |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e nxënësit dhe të punësuarve në institucionin arsimor dhe aftësues, si dhe të avancojë masat për parandalimin e braktisjes;<br>✓ të vendosë kritere dhe të menaxhojë një sistem të licencimit të mësimdhënësve, përmes Këshillit Shtetëror për Licencim të Mësimdhënësve, të themeluar sipas këtij ligji;<br>✓ të vendosë dhe mirëmbajë një sistem të informatave për menaxhimin e arsimit dhe aftësimit;<br>✓ t'i ofrojë komisionit për grante në baza vjetore të dhëna të mjaftueshme dhe standarde të formulës me qëllim të përcaktimit të grantit specifik për arsim në përputhje me ligjin në fuqi dhe dispozitat e nenit 28 të këtij ligji; të dizajnojë dhe mbikëqyrë format efektive të administrimit dhe menaxhimit të institucioneve arsimore dhe aftësuese për t'u zbatuar nga komunat dhe përcaktojë kritere dhe procedura të monitorimit të punës së Këshillit drejtues;<br>✓ të promovojë dhe të përmirësojë cilësinë dhe efikasitetin e arsimit dhe aftësimit përmes 6 mekanizmave të cekura në nenin 8 të këtij ligji për inspektim, monitorim, dhe vlerësim me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit në fuqi;<br>✓ të përcaktojë kriteret për vlerësimin dhe notimin e nxënësve në institucionet arsimore dhe aftësuese;<br>✓ të organizojë dhe të menaxhojë vlerësimin e jashtëm për nivelet 1, 2 dhe 3 të ISCED-it në përputhje me kërkesat për dhënien e kualifikimeve të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe, sipas nevojës, duke u konsultuar me Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve;<br>✓ të sigurojë politika gjithëpërfshirëse për integrimin e personave me nevoja të veçanta; |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | 1.13. të promovojë pjesëmarrjen dhe partneritetin e prindërve dhe komunitetit në aktivitetet arsimore dhe aftësuese përmes Këshillit të Prindërve të Kosovës, organeve udhëheqëse të institucioneve arsimore dhe aftësuese dhe përmes mënyrave tjera;<br>✓ Ministria emërton dhe riemërton institucionet publike arsimore dhe aftësuese në bazë të rekomandimit nga Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) përkatëse në bazë të propozimeve të bëra nga këshilli drejtues i institucionit arsimor apo aftësues, e që mund të jenë deri në tri propozime.<br><br>Kompetencat e Komunave janë të rregulluara me Ligjin për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L040, të datës 20 shkurt 2008, dhe Ligjin për arsim në komuna, nr. 03/L-068, të datës 21 maj 2008.<br><br>*Komunat kanë përgjegjësitë shtesë në vijim:*<br><br>✓ ndërtimin e objekteve arsimore dhe aftësuese;<br>✓ mirëmbajtjen dhe riparimin e ndërtesave dhe pajisjeve të institucioneve arsimore;<br>✓ sigurimin e një ambienti të shëndetshëm, duke përfshirë ujin e pijshëm, kushtet higjieniko-sanitare, shërbimin shëndetësor, si dhe ambient të sigurt për nxënësit dhe personelin duke përfshirë sigurimin e shërbimeve të sigurta dhe sigurisë efektive<br>✓ përmes bashkëpunimit me prindër, polici dhe autoritetet tjera publike, marrin hapa për të adresuar sjelljet e dhunshme dhe keqpërdorimin në ose në lidhje me institucionin përkatës. |
| **Ligji për arsimin dhe aftësimin** | https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8676 | Ministria e Arsimit, Shkencës, | Rregullon sistemin e arsimit dhe aftësimit profesional në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik dhe |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **profesional** (Nr. 04/L-138) | | Teknologjisë dhe Inovacionit<br><br>&<br><br>Agjencia e Arsimit dhe Aftësimit Profesional për të Rritur | shoqëror të Republikës së Kosovës, përfshirë ndryshimet ekonomike dhe teknologjike, kërkesat e tregut të punës dhe nevojat e individëve drejt ekonomisë së tregut, duke shfrytëzuar në mënyrë optimale burimet financiare, njerëzore dhe të infrastrukturës. I tërë autoriteti zbatues i është besuar MASHTI-t dhe Agjencisë së Arsimit dhe Aftësimit Profesional për të Rritur. **AAAPRr është përgjegjëse për:**<br><br>✓ administrim dhe udhëheqje të Institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional dhe për të rritur (IAAPRr) lidhur me burimet financiare, njerëzore, objekteve ndërtimore dhe infrastrukturës të të gjitha institucioneve publike të AAP nën administrimin e vet rregullativ;<br>✓ nën mbikëqyrjen e AAAPRr përgjegjësitë relevante të IAAPRr do t'u barten gradualisht shkollave duke u bazuar në kapacitetet e tyre;<br>✓ koordinimin e studimeve lidhur me arsimin dhe aftësimin profesional dhe të rriturve;<br>✓ koordinimin e projekteve ndërkombëtare;<br>✓ përfshirjen e partnerëve social në arsimin dhe aftësimin profesional dhe të rriturve;<br>✓ pjesëmarrjen e institucionalizuar të sektorit privat dhe partnerëve social në arsimin dhe aftësimin profesional dhe të rriturve;<br>✓ mbikëqyrë dhe koordinon zhvillimin e standardeve të profesionit. Gjithashtu, **Këshilli për arsimin dhe aftësimin profesional dhe për të rritur (KAAPRr)** është organ këshillëdhënës për MASHT, dhe funksionimi i këtij këshilli përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga MASHT. KAAPRr, ofron këshilla dhe rekomandon profilet për aprovim në të cilat duhet të bazohen programet e arsimit dhe aftësimit profesional, standardet për çdo profil, përmbajtjen profesionale të planprogramit për këto profile dhe |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | kualifikimet profesionale, që duhet të përfshihen brenda kornizës së kualifikimeve.<br>✓ rekomandon librat shkollor dhe materialet mësimore për shfrytëzim në programet e tilla;<br>✓ KAAPRr mund të themelojë komitete profesionale të përhershme dhe grupe punuese të përkohshme për të ndërmarrë aktivitete të veçanta, që mund të përfshijë mësimdhënësit, përfaqësuesit e partnerëve social dhe organizatave të bartësve të tjerë, profesionistët e sektorit dhe të tjerë, si dhe ekspertët shkencor në pajtim me rregulloret e nxjerra për punën e këtij këshilli;<br>KAAPRr miraton standardet e profesionit. |
| **Ligji për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovë** (Nr. 04/L-143) | https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2868 | Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit<br><br>&<br><br>Agjencia e Arsimit dhe Aftësimit Profesional për të Rritur | Rregullon tërësinë e proceseve për arsimimin dhe aftësimin e të rriturve, si pjesë përbërëse e sistemit arsimor në Kosovë. **Programet, kualifikimet dhe modulet e arsimit dhe aftësimit për të rritur, i hartojnë MASHTI, institucionet dhe ofruesit tjerë përkatës**, varësisht prej interesave dhe veprimtarisë së tyre me orientim në tregun e punës.<br><br>Ofruesit e arsimit dhe të aftësimit formal, i hartojnë programet dhe modulet e tyre, të cilat i akrediton AKK dhe i miraton MASHTI. Standardet e profesionit zhvillohen në bashkëpunim me MASHTI-n, AKK, MPMS, ministritë tjera relevante dhe partnerët social.<br>✓ Standardet e profesionit miratohen nga KAAPRr.<br>✓ Verifikimin e standardeve profesionale e bën AKK |
| **Ligji për kualifikime kombëtare** (Nr. 03/L- 060) | https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2606 | Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit | Krijon Sistemin Kombëtar të Kualifikimeve, që bazohet në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), të rregulluara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK). |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | &<br><br>Autoriteti Kombëtar i Kualifikimev e | |

**Përshkrimi i kuadrit ligjor ekzistues**

Konceptdokumenti për reformën e thjeshtësimit, konsolidimit dhe rritjes së efektivitetit të strukturës institucionale në fushën e arsimit dhe aftësimit profesionale ka analizuar fushën e AAP-së sa i përket aspektit rregullues ligjor, por edhe problemeve praktike gjatë zbatimit të kornizës ligjore. Gjatë identifikimit të problemit është analizuar korniza ligjore në fuqi, Strategjia e Arsimit 2022-2026 dhe raporte hulumtuese të tjera për fushën e arsimit dhe aftësimit profesional.

**Commented [KB14]:** Atehere, te lutem te prezanatohet kjo analize diku, sepse kjo analize po i mungon koncept-dokumentit.

**Commented [KB15]:** Mendoj qe reforma nuk do te duhej ta kishte theksin te thjeshtesimi dhe konsolidimi. Mjafton te jete qellim rritja e efikasitetit.

**Commented [KB16]:** Atehere eshte mire te referencohen te gjitha

**Ligjet që lidhen me arsimin dhe aftësimin profesional**

**Ligji për Arsimin Parauniversitar (Nr. 04/L-032)** rregullon edukimin, arsimin dhe aftësimin parauniversitar nga niveli 0 deri në 4 i ISCED-it duke përfshirë arsimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe të rriturve që marrin kualifikime në këto nivele. Ligji paraqet parimin se arsimi parauniversitar është përgjegjësi e përbashkët e shkollave, komunave dhe qeverisë qendrore. Ligji përbën një bazament horizontal të përgjithshëm për tërë fushën e arsimit parauniversitar, pa paragjykim ndaj arsimit dhe aftësimit profesional.

**Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (Nr. 04/L-138)** si ligj bazë për fushën e arsimit dhe aftësimit profesional rregullon strukturën, organizimin dhe drejtimin e institucioneve që ofrojnë arsim dhe aftësim profesional. Ky ligj gjithashtu themelon Agjencinë për Arsimin dhe Aftësimin Profesional të Arsimit të të Rriturve (AAAPARr) dhe Këshillin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe për të Rritur (KAAPRr). Ligji rregullon sistemin kombëtar të arsimit dhe aftësimit profesional i cili duhet të sigurojë përputhjen e arsimit me nevojat e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Republikës së Kosovës, duke përfshirë ndryshimet ekonomike dhe teknologjike, kërkesat e tregut të punës dhe nevojat e individëve drejt ekonomisë së tregut.

**Ligji për Arsimin e Lartë (Nr. 04/L-037)** i cili ka për qëllim krijimin i bazës ligjore për rregullimin, funksionimin, financimin, sigurimin e cilësisë ne arsimin e lartë ne përputhje me standardet evropiane si dhe rolin e shtetit dhe shoqërisë ne zhvillimin e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës. Sistemi i arsimit të lartë në Kosovë operon përmes universiteteve publike dhe institucioneve private të arsimit të lartë (kolegje, institute, shkolla të larta profesionale dhe akademive)

**Ligji për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (Nr.08/L-110)** i cili e rregullon statusin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), si agjenci rregullatore në proceset dhe përgjegjësitë e akreditimit, riakreditimit, validimit, monitorimit me qëllim të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë. AKA është mbikëqyrëse e sigurimit të cilësisë të programeve dhe institucioneve të arsimit të lartë që ofrojnë

programe akademike si dhe profesionale, më specifikisht e insticioneve që ofrojnë programe nga niveli 5-8 të KKK.

**Ligji për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës (Nr. 03/L-068) (Nr. 04/L-143)** i cili përcakton përgjegjësitë e komunave për menaxhimin e sistemit arsimor. Ligji u ofron komunave një nivel të rëndësishëm për të mikromenaxhuar arsimin publik brenda territorit të tyre, i cili përfshin edhe IAAP-të. Për të rregulluar decentralizimin e kompetencave arsimore, ligji u përshkruan komunave disa përgjegjësi specifike përfshirë punësimin në shkollë, menaxhimin e performancës së shkollës, monitorimin e cilësisë së ofrimit të arsimit si dhe menaxhimin e aktiviteteve që lidhen me infrastrukturën shkollore.

**Ligji për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur( Nr. 04/L-143)** i cili rregullon procesin për arsimimin e të rriturve si pjesë integrale e sistemit arsimor në Kosovë. Sipas këtij ligji, institucionet e arsimit dhe trajnimit të të rriturve i nënshtrohen monitorimit dhe auditimit nga AKK.

**Ligji për Kualifikime Kombëtare (Nr. 03/L- 060)** i cili rregullon zhvillimin dhe mirëmbajtjen e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe dhënien e kualifikimeve për të cilat autorizon Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve (me përjashtim të kualifikimeve që rregullohen sipas dispozitave të Ligjit për Arsimin e Lartë). Ligji rregullon gjithashtu ngritjen e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve dhe funksionet e tij.

**Ligji për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës (Nr. 06/L-046)** i cili rregullon mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit në fuqi në të gjitha institucionet që ofrojnë shërbime arsimore dhe trajnuese nga Inspektorati i Arsimit i Republikës së Kosovës.

**Ligji për Barazi Gjinore (Nr. 05/L-020)** i cili garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë. Ligji përcakton masat e përgjithshme dhe të veçanta për mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave të barabarta të femrave dhe meshkujve, si dhe përcakton institucionet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre.

**Ligji për Provimin e Maturës Shtetërore (Nr. 05/l -018)** i cili rregullon funksionin, përmbajtjen, kushtet, kriteret dhe mënyrën e organizimit të provimit të maturës shtetërore. Ligji përcakton detyrat e Komisionit Shtetëror të Maturës, Divizionit për Vlerësim, Standarde dhe Monitorim, Drejtorive Komunale të Arsimit dhe shkollave të mesme të larta.

**Ligji për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara (Nr.03/L-019)** i cili rregullon dhe përcakton të drejtat, kushtet, mënyrat e aftësimit, riaftësimit profesional dhe punësimi i personave me aftësi të kufizuara, për integrimin e tyre në tregun e hapur të punës sipas kushteve te përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në legjislacionin e aplikueshëm.

**Aktet nënligjore që janë të autorizuara në ligjet e fushës së arsimit dhe aftësimit profesional**

MASHTI ka miratuar një numër udhëzimesh administrative (UA) për të rregulluar aspektet e përcaktuara nga ligjet e shënuara më lartë. Kryesoret janë si në vijim:

MASHTI (2023) Udhëzim administrativ nr. 18/2023 për Këshilltarët në karrierë në IAP.

MASHTI (2023). Udhëzim administrativ nr. 10/2023 për Kriteret dhe procedurat e themelimit dhe pushimit të veprimtarisë së institucioneve të arsimit parauniversitar.

Rregullorja (Kjo në dokumentin përkatës referohet si rregullore, mirëpo në uebfaqen e MASHTI është e renditur si udhëzim administrativ

MASHT (2020) Udhëzim administrativ nr. 137/2020 për të mësuarit në vendin e punës në IAAP.

MASHT (2020). Udhëzimi administrativ nr. 106/2020 për Vlerësimin e performancës së drejtorit dhe nëndrejtorit të shkollave në institucionet e arsimit publik dhe trajnimit parauniversitar.

MASHT (2019). Udhëzimi administrativ nr.15/2019 për Detyrat, përgjegjësitë, procedurat dhe kriteret për emërimin e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit arsimor publik dhe trajnimit parauniversitar.

MASHT (2017). Rregullore nr. 01/2017 për Planifikimin dhe shpenzimin e të ardhurave të realizuara nga institucionet e arsimit dhe arsimit dhe aftësimit profesional për të rritur.

MASHT (2017). Udhëzimi administrativ nr. 04/2017 për Vlerësimin e performancës në institucionet arsimore.

MASHT (2016). Udhëzimi administrativ nr. 24/2016 për Sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar.

MASHT (2016). Udhëzimi administrativ nr. 23/2016 për Planin zhvillimor të shkollës dhe planin zhvillimor komunal të arsimit.

MASHT (2016). Udhëzimi administrativ nr. 17/2016 për Kushtet dhe kriteret e licencimit të institucioneve arsimore private parauniversitare dhe aftësimit profesional.

Udhëzimi administrativ nr. 04/2015 për Themelimin, funksionimin dhe përbërjen e këshillit për arsim dhe aftësim profesional dhe arsimin e të Rriturve.

MASHT (2014). Udhëzimi administrativ nr. 14/2014 për Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve (AAAPARr) në Kosovë.

MASHT (2014). Udhëzimi administrativ nr. 35/2014 Për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe miratimin e kualifikimit dhe akreditimit kombëtar të institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë.

MASHT (2014). Udhëzimi administrativ nr. 32/2014 për Kriteret dhe procedurat për sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional.

MASHT (2014). Udhëzimi administrativ nr.7/2014 për Avancimin, autonominë dhe funksionimin e institucioneve të AAP-së.

MASHT (2014). Udhëzimi administrativ nr. 32/2014 për Kriteret dhe procedurat për sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional-proceset e brendshme.

MASHT (2014). Udhëzimi administrativ nr. 04/2014 për Kushtet dhe kriteret e veprimtarisë ekonomike të institucioneve të AAP.

MASHT (2014). Udhëzimi administrativ nr. 01/2014 për Organizimin dhe planifikimin e procesit arsimor në AAP.

MASHTI (2014). Udhëzimi administrativ nr. 28/2014 për kriteret dhe procedurat për verifikimin e SP-ve [56];

MASHTI (2014). Udhëzimi administrativ nr. 31/2014 për njohjen e mësimit paraprak [48];

MASHT (2013). Udhëzimi administrativ nr. 34/2013 për Përbërjen, funksionin, detyrat, mandatin e përfaqësimit të Këshillit drejtues në institucionet e AAP.

MASHT (2013). Udhëzimi administrativ nr. 33/2013 për Zbatimin e formulës komunale për përcaktimin e ndarjes së buxhetit të shkollave për shkollat që administrohen nga komunat.

AKK (2011). Udhëzues për zhvillimin e mëtutjeshëm të sistemit të cilësisë për vlerësimin e jashtëm të AAP në Kosovë.

MASH (2009). Udhëzimi administrativ nr. 17/2009 për Procedurën e zgjedhjes së personelit arsimor në shkolla.

**Konteksti legjislativ i ndërlidhur me acquis**

Harmonizimi i ligjeve në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional është gjithashtu një obligim i Republikës së Kosovës që buron nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit. BE-ja ka zhvilluar disa rekomandime për fushën e arsimit dhe aftësimit profesional të cilave ky konceptdokument do t'iu referohet gjithashtu.

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në nenin 107 për fushën e arsimit dhe aftësimit thekson se palët do të bashkëpunojnë me qëllim të ngritjes së nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe arsimit dhe aftësimit profesional, si dhe politikave rinore dhe punës rinore në Kosovë, si mjete për të promovuar zhvillimin e aftësive, punësueshmërinë, përfshirjen sociale dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë. Palët gjithashtu do të bashkëpunojnë me qëllimin për të siguruar që qasja në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit në Kosovë të jetë pa diskriminim në bazë të gjinisë, origjinës racore ose etnike, fesë ose besimit, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual. Bashkëpunimi do të synojë të adresojë nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Më 24 nëntor 2020, Këshilli i BE-së miratoi një Rekomandim për arsimin dhe aftësimin profesional për konkurrencë të qëndrueshme, drejtësi sociale dhe fleksibilitet. Siç nënvizohet në rekomandim arsimi dhe aftësimi profesional ka një rol kyç në konkurrencën e qëndrueshme, drejtësinë sociale dhe qëndrueshmërinë për përgatitjen e të rinjve për të hyrë me sukses në jetën e punës dhe për nevojat e aftësimit dhe rikualifikimit të popullsisë në moshë pune, për të fuqizuar të gjithë me njohuri, aftësi dhe qëndrime për të lulëzuar në zhvillimin e tyre profesional, social dhe personal. Rekomandimi përcakton parimet kryesore për të siguruar që arsimi dhe aftësimi profesional të përshtatet me shpejtësi me nevojat e tregut të punës dhe ofron mundësi mësimi cilësor për të rinjtë dhe të rriturit. Rekomandimi vendos në fokus të fortë në rritjen e fleksibilitetit të arsimit dhe aftësimit profesional, mundësive të rritura për mësimin e bazuar në punë, praktikat dhe përmirësimit të sigurimit të cilësisë, të gjitha këto aspekte që do të adresohen fillimisht nga reforma e thjeshtësimit të strukturës institucionale përgjegjëse për arsimin dhe aftësimin profesional në Republikën e Kosovës.  Rekomandimet që dalin nga një analize e përputhshmërisë së reformës me acquis janë:

- ofrimi i një niveli autonomie për IAAP-të për t'i lejuar ata të reagojnë shpejt ndaj sfidave të aftësive, të ofrojnë programe të shpejta të rikualifikimit dhe të punojnë në partneritete të ngushta me punëdhënësit nga sektori publik dhe privat;
- modularizimi i programeve të arsimit dhe aftësimit profesional dhe zgjerimi i tyre në nivele më të larta të kualifikimeve;
- rritja e gatishmërisë digjitale të institucioneve të AAP-së;
- përcaktimin e treguesve për të mundësuar monitorimin sasior dhe cilësor të performancës së sistemeve të arsimit dhe aftësimit profesional.
- parimet, kriteret dhe treguesit e cilësisë në KKSC duhet të thjeshtohen, të bazohen në rezultate dhe të harmonizohen më mirë me EQAVET.

Këto rekomandime janë gjithashtu në linjë me Deklaratën e Osnabrück të 30 nëntorit 2020, e nënshkruar 0nga ministrat përgjegjës për arsimin dhe trajnimin profesional nga shtetet anëtare të BE-së, vendet kandidate, vendet EEA-EFTA (Zona Ekonomike Evropiane – Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë), partnerët socialë evropianë dhe Komisioni Evropian për Arsimin dhe Aftësimin Profesional si një Mundësues i Rimëkëmbjes dhe Tranzicionit të Drejtë drejt Ekonomive Digjitale dhe të Gjelbra. Të njëjtat janë në linjë me Programin Erasmus për 2021-2027, i menaxhuar nga Komisioni Evropian, Agjencia Ekzekutive Evropiane e Arsimit dhe Kulturës dhe agjencitë kombëtare Erasmus+, synim i të cilit është përmirësimi i cilësisë së AAP-së në të gjithë BE-në.

**Përvojat nga vende të tjera**

Me qëllim të hartimit të këtij konceptdokumenti janë analizuar praktikat nga vendet si Estonia, Kroacia, Sllovenia dhe Shqipëria. Arsyeja pse këto vende janë përzgjedhur është sepse të njëjtat kanë pasur rrugë të ngjashme të tranzicionit si dhe janë vende relativisht të vogla me shkallë të ngjashme sfidash.

Për çështje referimi tek AAP e Kosovës, shtyllat kryesore që janë marrë parasysh për të analizuar përvojat në këto vende janë: funksioni i agjencive përkatëse të AAP-së, në pjesëmarrjen aktive të punëdhënësve në aftësimin profesional, si dhe organizimin e Kornizave Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), dhe së fundi legjislacioni që ata kanë për bazë për të rregulluar dhe monitoruar AAP-në.

*Aspektet e mëposhtme mund të ofrojnë impulse për agjencinë e AAP-së:*

**Commented [KB17]:** Kjo pjese duket mjaft e varfer. Mendoj qe do te duhej te paraqiteshin elementet kryesore te disa vendeve te rajonit dhe vendeve te BE-se lidhur me qeverisjen dhe menaxhimin e AAP-se, ne vecanti te elementeve kryesore te legjislacionit te AAP. E gjithe kjo pjese eshte pershkrime qe nuk shihet si lidhen me qellime e ketij konceptdokumenti dhe nuk paraqet praktika qe mund te merren parasysh ne sistemin e AAP-se ne Kosove.

- Në vitin 2009, Estonia ka themeluar Agjencinë EKKA (Agjencia Estoneze e Cilësisë për Arsimin e Lartë dhe Profesional) tashmë e quajtur HAKA (Agjencia Estoneze e Cilësisë për Arsimin) e cila është qendra kryesore e kompetencave në fushën e arsimit në Estoni. Misioni i HAKA-s është të fuqizojë institucionet arsimore dhe palët e tjera të interesuara në avancimin e cilësisë së të nxënit dhe mësimdhënies, si dhe mbështetjen e zhvillimit të nxënësve. Në nivel kombëtar, oda ekonomike, konfederata e punëdhënësve dhe konfederata e sindikatave të tregtisë përfaqësojnë partnerët socialë. Punëdhënësit luajnë një rol aktiv dhe me ndikim në këshillat profesionale dhe zhvillimin e standardeve për çdo profesion. Në nivel lokal, partnerët social marrin pjesë në bordet këshilluese të shkollave të AAP-së.

- Sistemi kroat i AAP-së përfiton nga një agjenci e fortë e AAP-së, ASOO. Pra, ekziston një institucion qendror që formëson AAP-në në vend. Sipas sistemit Kroat të AAP, një agjenci mund të punojë më ngushtë me palët e përfshira, veçanërisht me punëdhënësit, sesa që mundet një ministri.

- Edhe Sllovenia ka krijuar një agjenci - Instituti i Republikës së Sllovenisë për Arsim dhe Aftësim Profesional (CPI) i cili ka për detyrë përgatitjen e propozimeve për zgjidhje dhe masa sistemore, si dhe mbështetjen e ofruesve të ndryshëm të arsimit dhe grupeve të tjera të interesit në fushën e arsimit profesional. Instituti po ashtu zhvillon hulumtime, monitoron dhe vlerëson sektorë ose elemente të veçanta të arsimit profesional. Në bashkëpunim me partnerët socialë, instituti zhvillon zgjidhje profesionale dhe drejton zhvillimin e arsimit profesional. Ai harton programe arsimore për aftësimin profesional, koordinon përgatitjen e tyre dhe siguron aplikimin dhe zbatimin e tyre. Instituti siguron mbështetje profesionale për stafin drejtues dhe specialistët e shkollave profesionale dhe grupeve të tjera të interesit, duke i këshilluar për planifikimin dhe zbatimin e masave edukative dhe aplikimin e zgjidhjeve profesionale.

Shqipëria po ashtu ka të themeluar **AKAFPK-në (Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve) i cili** është institucioni publik përgjegjës për përmirësimin e arsimit dhe aftësimit profesional, por e cila ka përgjegjësi të shumta, duke u përballur me sfida thelbësore që mes tjerash kanë të bëjnë me financimin e institucionit dhe kualifikimin e punonjësve. Ky është institucion vartës i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

*Aspektet e mëposhtme mund të ofrojnë impulse për përfshirjen e sektorit privat:*

Viteve të fundit, Kroacia dhe Sllovenia kanë aplikuar qasjet e aftësimit profesional dual. Sfidat janë të ngjashme dhe kanë të bëjnë me gjetjen dhe mbështetjen e qëndrueshme të kompanive të mjaftueshme që angazhohen në mënyrë aktive përmes aftësimit brenda kompanisë. Sistemet e AAP-së së këtyre vendeve sigurojnë masa të ndryshme mbështetëse për kompanitë për të inkurajuar pjesëmarrjen e tyre në arsimin profesional. Kjo mund të përfshijë stimuj financiarë, përfitime tatimore ose forma tjera të mbështetjes.

- Në vitin 2018, Ministria e Shkencës dhe Arsimit në Kroaci, lëshoi një program eksperimental të arsimit dhe aftësimit dual. Ky program përfshin shumë akterë, si ministritë, agjencitë, odat, shoqatat e punëdhënësve dhe institucionet partnere nga Gjermania, Austria dhe Zvicra. Programi fokusohet në të nxënit e bazuar në punë, zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe mentorëve, shkëmbimin e teknologjisë, monitorimin e progresit dhe provimet përfundimtare. Shkollat e AAP-së janë përgjegjëse për mësimdhënien, planifikimin e aktiviteteve mësimore të bazuara në punë dhe mbështetjen e mentorëve. Të nxënit e bazuar në

punë organizohet fillimisht në shkollat e AAP-së dhe më vonë kalon tek subjektet e biznesit. Subjekteve u kërkohet të ofrojnë aftësim për mentorë, të mundësojnë sigurimin e cilësisë dhe të ofrojnë pagesa mujore për nxënësit gjatë periudhave të të nxënit të bazuar në punë. Në Kroaci, kompanitë që ofrojnë praktika për nxënësit në programet 3-vjeçare të AAP-së kanë të drejtë të përfitojnë nga lehtësimet tatimore, duke ulur të ardhurat e tyre të tatueshme. Ndërmarrësit që aftësojnë një deri në tre nxënës në vit në ambientet e tyre mund të ulin të ardhurat e tyre të tatueshme për 5%; një nxënës shtesë zvogëlon më tej të ardhurat e tatueshme me 1 pikë përqindje, deri në një limit prej 15%.

Në Slloveni përpos zbatimit të formave të ngjashme me ato në Kosovë (praktikë profesionale me bazë në shkollë, praktikë në kompani, MVP) ekziston një model i bazuar në kontratë, ku praktikantët nënshkruajnë një marrëveshje me një kompani përgjegjëse për aftësimin e tyre praktik. Shkolla është përgjegjëse për pjesën teorike të aftësimit.

Në Shqipëri, ligji për AAP-në parashikon gjithashtu se sektori privat është i përfshirë në vlerësimin dhe vërtetimin e kualifikimeve. Kjo do të thotë që bizneset mund të përdorin ekspertizën dhe përvojën e tyre për të vlerësuar dhe konfirmuar cilësinë e aftësive dhe kompetencave të fituara. Kohëve të fundit vërehen partneritete të reja ndërmjet ofruesve të AAP-së, si shkollat profesionale dhe institucione të tjera arsimore, dhe bizneseve, për të siguruar që aftësimi t'i përmbushë kërkesat e tregut të punës.

*Sa i përket Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), në të gjitha përvojat e analizuara, këto janë disa nga ngjashmëritë dhe dallimet që ndërlidhen edhe me rolin e KKK në Kosovë:*

- Korniza e Kualifikimeve të Estonisë (EstQF) me tetë nivele u krijua në 2008, me Ligjin e Kualifikimeve Profesionale. EstQF ka 8 nivele, përshkrimet e niveleve të kualifikimit janë identike me përshkrimet e nivelit të KEK. Kualifikimet e AAP janë të shtrira në nivelet 2-5 të EstQF. EstQF është një kornizë gjithëpërfshirëse, e përbërë nga katër nën-korniza për:
  - kualifikimet e arsimit të përgjithshëm;
  - kualifikimet e AAP-së;
  - kualifikimet e arsimit të lartë;
  - kualifikimet profesionale.
- Në Kroaci, Korniza Kroate e Kualifikimeve (CROQF) është krijuar sipas Ligjit Kroat për Kualifikime në vitin 2013 (i ndryshuar në vitin 2018) nën juridiksionin e Ministrisë Kroate të Shkencës, Arsimit dhe Sportit (2013; Ministria Kroate e Shkencës dhe Arsimit, 2018). Si organi strategjik përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e CROQF u emërua Këshilli Kombëtar për Zhvillimin e Potencialit Njerëzor. Ajo përfshin tetë nivele dhe tri nënnivele (në nivelet 4, 7 dhe 8), të kategorizuara në bazë të rezultateve të të nxënit: njohuritë, aftësitë dhe niveli i autonomisë dhe përgjegjësisë. Ky nënnivelizim i kualifikimeve në Kornizë vjen si rezultat i ofertës mjaft të diversifikuar të AAP-së në Kroaci e cila krijon mundësi depërtueshmërie në disa rrugë të mëtutjeshme nga AAP fillestare.

- Në Slloveni, ligji i SQF-së, që është në fuqi që nga janari 2016, ofron udhëzime praktike për zbatimin e kornizës. Ai përshkruan përgjegjësitë e ministrive dhe palëve të interesit të përfshira në hartimin dhe ofrimin e kualifikimeve, i përcakton detyrat e Pikës Kombëtare të Koordinimit (CPI) me KEK dhe komitetit të ekspertëve të NCP SQF-KEK. Në Slloveni është krijuar një strategji e komunikimit, për të rritur dukshmërinë dhe përdorimin e kornizës midis grupeve të

ndryshme të përdoruesve, duke përfshirë tregun e punës. Si rrjedhojë, njohja dhe aplikimi i kornizës ka shënuar rritje, edhe në kontekstin e tregut të punës.

- Në Shqipëri qeverisja dhe mbikëqyrja e Kornizës Kombëtare Shqiptare, përfshin disa institucione kryesore, përkatësisht Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve. Këto institucione marrin kolektivisht përgjegjësinë për zbatimin dhe mirëmbajtjen efektive të KSHK-së. Pra, në Shqipëri nuk është themeluar një organ zyrtar i veçantë për mbikëqyrjen e KSHK-së. Mirëpo, duke njohur sfidat dhe kompleksitetin e gjatë të zbatimit të KSHK-së, si Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ashtu edhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë kanë krijuar një task-forcë. Kjo iniciativë bashkëpunuese, e mandatuar për një periudhë dyvjeçare sipas një Urdhri të përbashkët të Ministrave, synon t'i adresojë vështirësitë e identifikuara dhe të sigurojë mbarëvajtjen e procesit të zbatimit të KSHK-së në bashkëpunim me AKAFPK-në.

*Sa i përket kuadrit legjislativ, këto shtete kanë shumë pika të përbashkëta dhe të ngjashme me ato të Kosovës. Mirëpo për t'u veçuar janë këto shtete me këto veçori:*

- Më 12 dhjetor 2018, Parlamenti Estonez miratoi ndryshimet në ligjin e institucioneve të arsimit profesional për të ndërlidhur më mirë programet profesionale me tregun e punës dhe për të rinovuar parimet e financimit të shkollave profesionale. Sipas legjislacionit, parlamenti, qeveria dhe Ministria e Arsimit bashkërisht mbikëqyrin sistemin e AAP-së në nivel kombëtar. Ministria e Arsimit miraton kurrikulat kombëtare të AAP-së. Ndërsa, nga viti 2012, fondacioni **Innove** ka zbatuar politikën kombëtare të arsimit, siç përcaktohet nga ministria e arsimit. Fondacioni organizon zhvillimin e kurrikulave kombëtare, mbështet zbatimin dhe organizon trajnimin e mësimdhënësve të AAP-së. Disa organe këshillimore dhe organizata partnere sociale marrin pjesë në zbatimin e politikave. Pushteti lokal përgatit dhe zbaton planet zhvillimore të arsimit lokal, si dhe koordinon aktivitetet e institucioneve komunale arsimore. Pjesëmarrja e partnerëve social në AAP rregullohet nga legjislacioni kombëtar dhe marrëveshjet e partneritetit.
- Ligji i veçantë i Sllovenisë dhe Kroacisë që rregullon dhe monitoron AAP- në e lartë. Ky fakt mund të vë në pah rëndësinë që këto dy shtete ia kushtojnë nivelit të AAP-së në zgjerimin dhe diversifikimin e ofertës për të diplomuarit e AAP-së fillestare dhe asaj të vazhdueshme si formë për të ngritur depërtueshmërinë. Përmes këtyre ligjeve rregullohet dhe definohet roli i monitorimit dhe sigurimit të cilësisë të kësaj oferte që dallon qartë nga ajo akademike. Të dyja shtetet ofrojnë programe të niveleve të ndryshme të AAP të vazhdueshme si dhe në nivel të arsimit të lartë.
- Në Shqipëri dominon qeverisja e AAP-së e centralizuar dhe bartës kryesor i politikëbërjes është Ministria e Financave dhe Ekonomisë që përfshinë të dyja format e AAP-së: fillestare dhe të vazhduar (formale dhe joformale – pra, përfshirë këtu edhe atë të ofruar përmes masave aktive të punësimit).

**Pema e problemit**

Qeverisja e arsimit dhe aftësimit profesional në Republikën e Kosovës përbën një kuadër institucional që është shumë kompleks, i shtrirë në shumë shkallë vendimmarrëse, i fragmentuar në një format jo-proporcional në raport me një qëllim legjitim dhe mbi të gjitha i shpërqendruar në disa drejtime jo shumë të qarta përgjegjësish. Ky format i organizimit ka prodhuar një mungesë serioze të konsolidimit të politikës, qeverisjes dhe kontrollit të cilësisë së institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional. Mungesa e një qeverisjeje të konsoliduar, pa një format unitar të legjislacionit dhe në mungesë të një

**Commented [KB18]:** Askund nuk eshte shtjelluar permes prezantimit te argumenteve se si vijme ne kete konkluzion. Nuk besoj qe ky konstatim qendron. Kosova nuk dallon nga vendet tjera ne kuadrin institucional. Nuk mendoj qe keto jane problemet e kuadrit institucional. Problemet me shume nderlidhen me kapacitetet.

**Commented [KB19]:** Mjaft e cuditshme qe ne nje dokument zyrtar te Ministrise, pershkruhet ne kete forme kaq kritike e gjitha puna e vete Ministrise.

zingjiri të qartë kontrolli cilësi ka prodhuar një situatë të paqëndrueshme qeverisjeje, kualiteti, produktiviteti dhe shkëputjeje nga kërkesat e tregut të punës.

*Figura 3: Pema e problemit që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet*

| | |
|---|---|
| **Efektet** | 1. Mungesë e cilësisë në rezultatet e mësimdhënies<br>2. Mungesë e përfshirjes së akterëve të industrisë në mënyrë direkte në planifikim dhe zbatim të politikave AAP<br>3. Shkëputje e lidhjes së programeve të arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e kohës së sotshme të tregut të punës<br>4. Koordinim i pamjaftueshëm ndërmjet niveleve qeverisëse sa i përket prioriteteve, zbatimit të tyre dhe qeverisjes praktike të shkollave/institucioneve të AAP<br>5. Mungesë e llogaridhënies të bazuar në performancë/produktivitet (output) dhe mungesë e planifikimit të duhur të resurseve dhe shpërndarjes së tyre (input)<br>6. Mungesë e një sistemi të kontrollit të cilësisë dhe përdorim të tij në zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të kualifikimeve të mësimdhënësve<br>7. Barrë e shtuar administrative në qeverisjen e arsimit dhe aftësimit profesional. |
| **Problemi kryesor** | **Harmonizim dhe konsolidim i pamjaftueshëm i institucioneve qeverisëse të AAP-së.** |
| **Shkaqet** | 1. Numër i madh i institucioneve të përfshira, pa një ndarje të qartë të kompetencave dhe përgjegjësive.<br>2. Dyfishim i përgjegjësive në fushën e AAP-së.<br>3. Mungesë e funksioneve administrative dhe e kapaciteteve profesionale.<br>4. Mungesë e mekanizmave koherent të kontrollit, mentorimit dhe monitorimit të performancës, bazuar në rezultate.<br>5. Një tërësi aktesh legjislative të paharmonizuara, dhe të shpërndara në shumë instrumente. |

Figura e mëposhtme liston palët e interesuara të identifikuara. Gjithashtu tregon nëse ato janë prekur nga shkaqet, efektet ose të dyja. Përveç kësaj, kolona e fundit në përmbledhje tregon se si ato janë të prekura. Kapitulli 5 jep informacionin se si janë konsultuar këto palë të interesuara.

*Figura 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit*

| Emri i palës së interesuar | Shkaku-qet me të cilat është e lidhur pala | Efekti-et me të cilat është e lidhur pala | Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet) |
|---|---|---|---|



**Commented [KB20]:** Cka konkresisht nuk eshte konsoliduar ne qeverisje? Cka mendohet me nje format unitar te legjislacionit? Edhe sipas ketij koncepti Kosova do te kete disa ligje qe nderlidhen me AAP dhe nje ligj baze per AAP. Keshtu eshte situata edhe aktualisht. A nuk eshte AKK institucion qe megjithate ben perpjekje per nje kontroll te cilesise? Kam pershtypjen qe edhe ne raporte te pavarura nderkombtare situata paraqitet pak me mire se ne kete dokument lidhur me qeverisjen dhe sigurimin e cilesise ne AAP.

**Commented [KB21]:** Nuk po nderlidhen efektet e paraqitura ne menyre te drejtperdrejt me shkaqet e meposhtme, e as me efektet e mesiperme.

**Commented [KB22]:** Realisht jane vetem 3 institucione te perfshira: MASHTI, AAAPARr dhe AKK. Nuk duket te jete numer edhe aq i madh. Sidoqofte, cilat kompetenca dhe pergjegjesi nuk jane te ndara qarte dhe cilat pergjegjesi jane te dyfishuara? Do te ishte mire te jemi me specifik, sepse keshtu nuk i kontribojme procesit te hartimit te ligjit per AAP.

**Commented [KB23]:** Si me larte, specifikisht cilat funksione kryesore administrative mungojne?

**Commented [KB24]:** Duket qe fjala eshte per Udhezimet Administrative. Do te duhej te shtjellohet dhe argumentohet diku se cka dhe qysh jane te paharmonizuara keto akte ligjore.

**Commented [KB25]:** A eshte konsultuar sektori privat?

**Commented [KB26]:** Sektori privat nuk paraqitet fare si pale me interes dhe nuk jepet fare ne tabelen e meposhtme.

| | | | |
|---|---|---|---|
| Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit | Barrë e panatyrshme dhe e shtuar administrative në qeverisjen e arsimit dhe aftësimit profesional; mungesë e proceseve të digjitalizuara.<br><br>Dyfishim i përgjegjësive në fushën e AAP-së;<br><br>Numër i madh i institucioneve të përfshira pa një ndarje të qartë të përgjegjësive e detyrave;<br><br>Një tërësi aktesh legjislative të paharmonizuara dhe të shpërndara në shumë instrumente; | Mungesë e cilësisë në rezultatet e mësimdhënies;<br><br>Koordinim i pamjaftueshëm ndërmjet niveleve qeverisëse sa i përket prioriteteve, zbatimit të tyre dhe qeverisjes praktike të shkollave/institucioneve të AAP;<br><br>Mungesë e llogaridhënies të bazuar në performancë/produktivitet (output) dhe mungesë e planifikimit të duhur të resurseve dhe shpërndarjes së tyre (input); | Përgjegjësi politikbërëse e Ministrisë që të sigurojë një sistem të lehtë e racional të qeverisës së arsimit dhe aftësimit profesional ; |
| Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve | Mungesë e një zingjiri koherent të kontrollit të performancës së bazuar në rezultate;<br><br>Një tërësi aktesh legjislative të paharmonizuara dhe të shpërndara në shumë instrumente; | Shkëputje e lidhjes së programeve të arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e kohës së sotshme të tregut të punës;<br><br>Mungesë e një sistemi të kontrollit të cilësisë dhe përdorim të tij në zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të kualifikimeve të mësimdhënësve; | Përgjegjësi administrative e agjencisë |
| Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve | Mungesë e një zingjiri koherent të kontrollit të performancës së | Shkëputje e lidhjes së programeve të arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e kohës së | Përgjegjësi administrative e agjencisë |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | bazuar në rezultate | sotshme të tregut të punës;<br><br>Mungesë e një sistemi të kontrollit të cilësisë dhe përdorim të tij në zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të kualifikimeve të mësimdhënësve; | |
| Këshilli për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe për të Rritur | Mungesë e një zingjiri koherent të kontrollit të performancës së bazuar në rezultate | Shkëputje e lidhjes së programeve të arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e kohës së sotshme të tregut të punës | Përgjegjësi këshilluese e këshillit |

## Kapitulli 2: Objektivat

Ky konceptdokument synon t'i arrijë një numër objektivash që lidhen me synimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndërlidhjen e arsimit dhe aftësimit profesional me tregun e punës dhe përshtatjen e programeve arsimore e aftësuese me kërkesat në rritje të industrive në tregjet konkurruese në Evropë e më gjerë.

*Figure 5: Objektivat relevante të Qeverisë*

| **Objektivi relevant** | **Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)** |
|---|---|
| Harmonizimi i arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e tregut të punës | Programi Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 |
| Rimëkëmbja Ekonomike - krijimi i vendeve të reja të punës dhe zhvillimi ekonomik | Programi Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 |
| Treg i punës gjithëpërfshirës, punësim më i lartë dhe i denjë | Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2030 |
| Zhvillimi i aftësive dhe zgjerimi i shërbimeve të punësimit; | Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2030 |

| | |
|---|---|
| Harmonizimi i arsimit dhe aftësimit profesional me zhvillimet dinamike të teknologjisë dhe tregut të punës, në funksion të mësimit gjatë gjithë jetës | Strategjia e Arsimit 2022 – 2026 |

Objektivat e këtij konceptdokumenti i shërbejnë zbatimit të dokumenteve të mëposhtme strategjike:

1. Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2030, përkatësisht objektivit të harmonizimit më të mirë të arsimit me nevojat e tregut të punës;
2. Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025, përkatësisht objektivit të harmonizimit të arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e tregut të punës;
3. Programit për Reforma në Ekonomi 2022-2024 BE-Kosovë, përkatësisht masës së reformës 1: 'Përshtatja e Arsimit dhe Aftësimit Profesional me nevojat e tregut të punës';
4. Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2022-2026, pjesa e acquis në fushën e arsimit, dhe,
5. Strategjia e Arsimit 2022-2026, në objektivat që ndërlidhen me qeverisjen dhe sigurimin e cilësisë në arsimin dhe aftësimin profesional dhe në adresimin e sfidave në nivel të shkollave.

Objektivat specifike të këtij koncept dokumenti janë, si më poshtë (të përshkruara në nën-seksione specifike):

***Objektivi 1:* Ristrukturimi i institucioneve qendrore të fushës së arsimit dhe aftësimit profesional**

***Objektivi 2*: Fuqizimi i agjencisë me një qark të plotë te kompetencave në fushën ekzekutive, administrative, rregullative në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional dhe KKK-së**

***Objektivi 3*: Harmonizimi i ligjeve të fushës së arsimit dhe aftësimit profesional në një akt ligjor**

***Objektivi 4*: Krijimi i mekanizmave të pavarur me përgjegjësi për** akreditim e IAAP-ve **në kuadër të agjencisë.**

***Objektivi 5*: Parashikimi i një mekanizmi që i ndërlidh programet e arsimit dhe aftësimit profesional me nevojat e tregut**

***Objektivi 6*: Krijimi i një qarku llogaridhënës në qeverisjen e arsimit dhe aftësimit profesional**

## Kapitulli 3: Opsionet

Reforma në AAP në kontekst të thjeshtësimit, konsolidimit dhe rritjes së efektivitetit të strukturës institucionale në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional duhet të ketë këto qëllime (të cilat janë të zbërthyera në pjesën e mëposhtme në objektiva specifike):

1. Harmonizimin e ligjeve të fushës së arsimit dhe aftësimit profesional në një akt të vetëm ligjor;



**Commented [KB27]:** Objektivi 1 dhe 2 mund te jene nje objektiv i vetem "**Ristrukturimi i institucioneve qendrore të fushës së arsimit dhe aftësimit profesional permes fuqizimit të agjencisë së AAP-së me një qark të plotë të kompetencave në fushën ekzekutive, administrative, rregullative në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional dhe KKK-së".**

**Commented [KB28]:** Nuk mendoj qe kjo qendron. Ky koncept dokumenti nuk po pretendon qe do te kete vetem nje ligj per gjithe fushen e AAP-se. Sigurisht qe do te mbetet ligji per kualifikimet kombtare, ligji per arsimin parauniversitar, ligji per arsimin ne komuna, ligji per arsimin per te rritur, te cilet do te vazhdojne me mbulu segmente te fushes se AAP-se.

**Commented [KB29]:** Te gjitha objektivat tjera 1,2,4,5,6 po lidhen me agjencine e AAP-se apo me funksionet qe agjencia e re do t'I kete, mirepo objektivi 3 del tani pertej ketyre. Eshte e qarte qe themelimi i agjencise se re me funksionet dhe mandat te fuqizuar kerkon qe kjo te refelektohet edhe ne ndryshime ligjore, por kjo do te duhej te ishte hapi I fundit, pasi te shterren te gjitha argumentet, konsultimet lidhur me funksionet e reja te agjencise dhe menyren e organizimin te saj. Per me teper, ky objektiv po i perjashton opsionin 1 dhe 2, sepse ne opsionin 1 dhe 2 nuk trajtohen ndryshime ligjore. Kjo ne fakt, i ben ato ne opsione fiktive, sepse nese harmonizimi i ligjeve te fushes se AAP-se eshte qellimi, atehere opsionet 1 dhe 2 nuk mund jene fare opsione, sepse nuk e reflektojne fare qellimin.

**Commented [KB30]:** Agjencia aktuale e AAP-se ka ne menaxhim IAAP/Qendrat e Kompetences. Ky eshte edhe modeli kroat i agjencise se AAP-se. Vetem se ne kete rast nje agjenci e cila ka IAAP ne menaxhim nuk mundet te jete pergjegjese edhe per akreditim, perkatesisht sigurimin e jashtem te cilesise. Nese Agjencia e AAP-se vendohet te merret me akreditim, atehere Qendrat e Kompetences nuk mund te jene tutje nen menaxhimin e saj. Nuk mendoj qe kjo do te ishte gjeja e duhur dhe do te ishte shume e demshme dhe prapakthim edhe per sigurimin e cilesise ne AAP edhe per Qendrat e Kompetences. Ne shumicen e sistemeve te AAP-se ne rajon, Qendrat e Kompetences jane nen menaxhim te agjencise, ndersa sigurimi I jashtem I cilesise behet nga institucione te pavaruara te ndara.

**Commented [KB31]:** Nuk eshte e qarte per cfare mekanizmi eshte fjala qe i nderlidh programet e arsimit dhe aftesmit profesional me nevojat e tregut, sidoqofte mendoj qe formulimi do te duhej te jete me konciz.

**Commented [KB32]:** 3 opsionet do te duhej te shtjelloheshin, krahasoheshin bazuar ne kritere te perbashket qe bazohen ne objektivat e percaktuara te koncept dokumentit. Ky nuk eshte rasti me keto opsione.

**Commented [KB33]:** Nuk mendoj qe kjo qendron. Ky koncept dokumenti nuk po pretendon qe do te kete vetem nje ligj per gjithe fushen e AAP-se. Sigurisht qe do te mbetet ligji per kualifikimet kombtare, ligji per arsimin parauniversitar, ligji per arsimin per te rritur, etj, te cilet do te vazhdojne me mbulu segmente te fushes se AAP-se.

2. Njësimin e tërë strukturave të formës 'agjenci ekzekutive' apo trupa të ngjashme të themeluara me ligje apo akte nënligjore në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional, në një trupë të vetme, preferueshëm të formës agjenci e re ekzekutive pranë Ministrisë së Arsimit;
3. Fuqizimin e trupës së re me gamën e nevojshme të kompetencave në funksionet ekzekutive/administrative, mbështetëse, asistuese, financuese për IAAP-të dhe IAAPRr-të, dhe politikbërëse në të gjitha komponentët përveç politikave publike të formës ligj (të cilat mbesin përgjegjësi e DAAP-së);
4. Vendosjen e garancioneve të nevojshme të pavarësisë për komponentët vendimmarrës brenda trupës së re, të cilat janë përgjegjëse për akreditimin e IAAP-ve dhe IAAPRr-ve në kuptim të KKK-së;
5. Ndërlidhjen e vendimmarrjes së trupit të ri, në çështjet që janë kyçe për efektin përfundimtar të të diplomuarve në tregun e punës dhe sektorin e industrive të specializuara, në mënyrë të tillë që vendimmarrja e jetë e formatit korporativ (me industritë apo koalicionet/grupet e tyre si akter qendror në vendimmarrje);
6. Krijimin e një linjë të qartë të llogaridhënies për trupën e re, dhe krijimin e një mekanizmi ligjor që parasheh transparencë dhe performancë të bazuar në rezultate përballë tri audiencave: a) Ministrisë së Arsimit, si institucioni ndaj së cilës trupa do ketë vartësi institucionale, b) IAAP-ve/IAAPRr-ve, të cilëve trupi i ri do i shërbej por edhe menaxhoj në kuptim të kompetencave të nivelit qendror, dhe, 3) akterëve në tregun e punës, ndaj të cilëve trupi i ri duhet tu dëshmojë dhënien e rezultateve në perspektivën e benefituesit përfundimtar.

Ndërlidhur me këto qëllime, koncept dokumenti adreson tri opsione. Opsioni i parë është opsioni pa asnjë ndryshim apo ruajtja e status qou-së. Opsioni i dytë është përmirësimi i situatës me ndryshime në aktet ligjore veç e veç, dhe opsioni i tretë është miratimi i një ligji të ri kodifikues për fushën e arsimit dhe aftësimit profesional. Opsionet e parashtruara duhet të mundësojnë arritjen më të shpejtë të qëllimeve të parashtruara në kapitullin 1 të këtij koncept dokumenti ('përkufizimi i problemit').

## Kapitulli 3.1: Asnjë ndryshim ligjor, por vetëm intervenime riparuese në nivel të dokumenteve të brendshme organizative të institucioneve në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional (Opsioni asnjë ndryshim)

Sipas këtij opsioni nuk rekomandohet asnjë ndryshim në kornizën ligjore bazë të arsimit dhe aftësimit profesional dhe as në aktet nënligjore. Me aplikimin e opsionit pa ndryshim, vështirësitë e paraqitura më lartë do të vazhdojnë të qëndrojnë. Intervenimet në nivelin e dokumenteve të brendshme organizative, përkatësisht akteve të brendshme të organizimit dhe sistematizimit të vendeve të punës, janë të pamjaftueshme dhe nuk garantojnë ndryshim të strukturës institucionale të fushës së arsimit dhe aftësimit profesional në kuptimin e menduar në Kapitullin 1 dhe në Kapitullin 2 ('objektivat'). Gjithashtu, intervenimi në nivelin e dokumenteve të brendshme organizative nuk mundëson ndryshim të procedurave e përcaktimeve në bazën ligjore që janë miratuar në periudha të ndryshme kohore dhe si të tilla nuk ndjekin një qasje të harmonizuar/unifikuar. Sipas këtij opsioni, gjendja e shoqëruar me mungesë të një kuadri të qartë e të harmonizuar institucional e ligjor do të vazhdonte të ekzistonte, përfituesi fundit do të vazhdonte të vuante pasojën e këtij problem, kurse tregu i punës do të vazhdonte të ishte i paharmonizuar me programet e arsimit dhe aftësimit profesional. Kjo gjendje do e rëndonte edhe më shumë situatën e pafuqishme të shkathtësive prezente në tregun e punës, si pasojë e të cilave ekonomia shërbyese e prodhuese do i bartte pasojat e një kosto shumë të lartë, gjendjeje jokompetitive në tregun regjional dhe humbjen e fuqisë punëtore që kërkon kualifikim profesional në sistemet e huaja arsimore. Rrjedhimisht, nuk sugjerohet të ndiqet ky opsion sepse ndryshimet tekniko-teknologjike, nevojat e tregut/industrisë, nevojat për shkathtësitë e reja, modalitetet e reja të të mësuarit në AAP në fushën e kualifikimeve dhe rikualifikimeve nuk mbulohen me gjendjen aktuale dhe ka barrë administrative.

**Commented [KB34]:** Nga kjo kuptohet qe edhe udhezimet administrative do te nxjerren nga Agjencia e re? A eshte kjo ne perputhje me mandatin e agjencive te pavaruara sic percaktohet me ligjin perkates per agjencite?

**Commented [KB35]:** Agjencia aktuale e AAP-se ka ne menaxhim IAAP/Qendrat e Kompetences. Ky eshte edhe modeli kroat i agjencise se AAP-se. Vetem se ne kete rast nje agjenci e cila ka IAAP ne menaxhim nuk mundet te jete pergjegjese edhe per akreditim, perkatesisht sigurimin e jashtem te cilesise. Nese Agjencia e AAP-se vendohet te merret me akreditim, atehere Qendrat e Kompetences nuk mund te jene tutje nen menaxhimin e saj. Nuk mendoj qe kjo do te ishte gjeja e duhur.

**Commented [KB36]:** Institucionet si AAAPARr, AKK, nuk kane dokumente te brendshme organizative, pothuajse gjithcka percaktohet me akte nenligjore nga Ministria.

**Commented [KB37]:** Nuk mendoj qe ky opsion po paraqitet ne menyre adekuate. Mbase do te duhej te ishte opsioni, nderhyrje permes akteve nenligjore, pa ndryshim te ligjit. Keshtu sic eshte paraqitur ne kete dokument - nuk perben fare opsion.

**Commented [KB38]:** Cka nuk mbulohet ne legjislacionin aktual konkretisht? Avancimet teknologjike, dinamikat e tregut te punes dhe shkathtesite do te ndryshojne gjate gjithe kohes, e rendesishme eshte qe ligji ofron nje platforme rregullative mundesuese ndaj dinamikave zhvilluese. Cka nga keto dinamika pengohet nga legjislacioni aktual?

### Kapitulli 3.2 Adresimi i reformës përmes përmirësimit të dokumenteve strategjike të fushës së arsimit dhe aftësimit profesional dhe të KKK-së (Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit)

Ky opsion përfshin adaptimin e bazës së dokumenteve strategjike në drejtim të rritjes së koordinimit dhe efiqencës së bashkëpunimit të institucioneve qeverisëse të fushës së AAP-së. Bazuar në këtë opsion, MASHTI do të duhej të rishikonte strategjinë përkatëse të arsimit dhe aty të parashikonte një ndryshim të formave të bashkëpunimit ndërmjet tre instancave qeverisëse të AAP-së, të parashikonte një plan të aktiviteteve koordinuese ndërmjet tyre dhe të parashikonte eventualisht një strategji të re të bashkëpunimit të bazuar në projekte e plane konkrete për të tria. Ky opsion do të rriste planifikimin e politikave në raport me koordinimin dhe bashkëpunimin e institucioneve të AAP-së dhe gjithashtu do të përcaktonte në një formë të shkruar aktivitetet e tyre të përbashkëta, ndarjen e përgjegjësive operacionale sipas mandatave të tyre dhe ndarjen e detyrave për të arrirë qëllimet e përbashkëta. Intervenimi në nivelin e dokumenteve strategjike megjithatë do të kishte impakt të ulët në rezultatet e pritura. Institucionet e AAP-së megjithatë do të mbeteshin si trupa të ndara, me baza ligjore tërësisht të pa harmonizuara dhe me një mandat të shpërndarë në drejtime jokoherente. Për më tepër, intervenimi në nivelin strategjik nuk do të prodhonte asnjë ndryshim në raport me objektivin e ndërlidhjes së AAP-së me tregun e punës, dimension që kërkon një themelim të mekanizmit të parashikuar me ligjin në fuqi të AAP-së. Në anën tjetër, kompleksiteti i jashtëzakonshëm institucional e administrativ do të vazhdonte të kishte të njëjtën formë e përmbajtje, duke mos e afektuar pozitivisht statusin e përfituesit fundor, nxënësin. Prandaj, ndjekja e këtij opsioni nuk është e rekomandueshme për shkak të pamundësisë së tij për t'i arritë rezultatet e parashikuara në seksionin e 'objektivave'.

### Kapitulli 3.3: Adresimi i reformës së strukturës institucionale të arsimit dhe aftësimit profesional dhe KKK-së në Republikën e Kosovës përmes plotësim-ndryshimeve të ligjeve individuale ((Opsioni i tretë))

**Ky opsion përfshin përditësimin e tërë kuadrit aktual ligjor fillimisht përmes hartimit dhe miratimit të një ligji bazë për fushën e AAP-së dhe pastaj, në një periudhë të dytë dyvjeçare, plotësim-ndryshimet e dy ligjeve tjera të ndërlidhura, atë të KKK-së dhe të AAP-së për të rritur (arsimit tërëjetësor). Mbi një bazë të tillë më pastaj do të përditësohen aktet nënligjore në përputhje me parashikimet e kësaj reforme.** Me adresimin e plotësim-ndryshimeve të tre ligjeve aktuale, përveçse do të avancohet reforma e racionalizimit dhe fuqizimit institucional të AAP-së, gjithashtu do të arrihet objektivi i harmonizimit, materien e arsimit/aftësimit profesional dhe asaj të KKK-së me standardet ndërkombëtare e evropiane në fushën e kualifikimeve.

Ky opsion, pra Opsioni i tretë, parashikon plotësim-ndryshimet e individualizuara të ligjeve në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional, fillimisht plotësim-ndryshimin e Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional në Republikën e Kosovës gjatë vitit 2024. Më pastaj, pasi të jetë mirë-vendosur bazamenti i reformës së AAP-së në ligjin bazë, përgjatë viteve 2025 dhe 2026 do të plotësohen-ndryshohen Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional për të Rritur dhe Ligji për KKK-në. Baza e shpërndarë ligjore, në së paku tre ligje, Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional në Republikën e Kosovë dhe Ligji për Arsimin dhe Aftësimin për të rritur dhe Ligji për Kualifikime Kombëtare, ka krijuar një format të ndërlikuar dhe jo-uniform të rregullimit ligjor për fushën e arsimit dhe aftësimit profesional. Ky fragmentim ligjor, që ka qenë reflektim i proceseve të ndara e vështirë të ndërlidhshme ligjbërëse, e ka bërë shumë të vështirë,

**Commented [KB39]:** Pse do te kishte impakt te ulet? Apo ndryshe, pse intervinimi ne legjislacion mendohet qe do te kete impakt me te madh?

**Commented [KB40]:** Nuk mendoj qe qendron ky konstatim dhe per mendimin tim eshte plotesisht I pabazuar. Kudo ne rajon e me gjere, 2-3 institucione te ndara jane pergjegjese per segmente te caktuara te AAP-se. Ato jane te ndara per nje arsyeje dhe te tilla duhet jene. Baza ligjore e tyre eshte Ligji per AAP-ne, Ligji per Kualifikimet Kombetare - ligje keto qe jane te ndara me shumicen e sistemeve.

**Commented [KB41]:** Keto jane konstatime, askund nuk ofrohen argumentet. Nuk mendoj qe sistemi jone I AAP-se karakterizohet me "kompleksitet te jashtezakonshem institucional e administrativ".

**Commented [KB42]:** Tani ketu po konfirmohet qe nuk qendron ajo qe thuhet ne objektivin 1, harmonizimi I akteve ligjore ne nje ligj te vetem. Pra, do te kemi ligje te ndara qe rregullojne fushen e AAP-se.

**Commented [KB43]:** Mendoj qe edhe arsimi per te rritur duhet jete pjese e Ligjit per AAP-ne dhe nuk ka nevoje per ligj te vecante.

**Commented [KB44]:** Tani kjo eshte konfuze, si do te permbledhet pra kjo "baze e shperndare ligjore"?

difuz dhe të pakoordinuar zbatimin e ligjeve në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional. Kjo nënkupton që Objektivi 1 dhe Objektivi 2 do të duhej të shoqëroheshin me Objektivin 3, atë të harmonizimit të materies së tre ligjeve, ashtu siç do të duhej të kishte qenë natyrshëm nga fillimi. Bashkimi i tre mekanizmave institucional në një agjenci të vetme ekzekutive e bën edhe më të nevojshëm harmonizimin e materies së tre ligjeve, përkatësisht ligjin e ri për arsimin dhe aftësimin profesional, atë për të rritur dhe për kornizën e kualifikimeve. Harmonizimi do t'i shërbente qëllimit të thjeshtësimit përmes uniformimit të bazës ligjore, dhe ku do të mënjanoheshin mangësitë në ndërlidhje të KKK-së me sektorin e politikbërjes së përgjithshme të arsimit dhe aftësimit profesional, por në anën tjetër do krijoheshin lidhje me industrinë bazuar në të njëjtin qark ligjor, e jo në formë paralele siç është aktualisht. Përmes këtyre ndryshimeve, do të parashiheshin një mori klauzolash që do e adresonin harmonizimin e tyre, përkatësisht uniformimin e tyre, në drejtim të një politike të unifikuar sa i përket qeverisjes së AAP-së. Ligji i ri do të themelojë agjencinë përkatëse për arsimin dhe aftësimin profesional, që i fuzionon dy agjencitë paraprake, dhe do të përcaktojë në dispozitat e saj tranzitore tranzicionin e nëpunësve civil, organizimin e brendshëm dhe trashëgiminë e memories institucionale (dhe vendimmarrëse) për dy agjencitë pararendëse. Ligji i ri do të garantojë përputhshmëri me Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, e gjithashtu do të parashohë mekanizmat e përshkruar në kapitullin 2 ('objektivat). Përmes ligjit të ri do të parashikohej një agjenci ekzekutive e mirë-pajisur me kompetenca të plota ekzekutive administrative dhe rregullative dhe një mandat fillestar për të fuqizuar, përkrahur dhe kontrolluar cilësinë e institucioneve të AAP-së dhe programeve të tyre. Struktura aktuale institucionale në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional do thjeshtësuar dhe unifikuar në një trupë të vetme. Që të përmbushet ky objektiv, është i nevojshëm fuzionimi i AAAPRr-së dhe AKK-së në një trupë të vetme. Një fuzionim i tillë është në përputhje me pritjet e Bashkimit Evropian në kuptim të Reformës së Administratës Publike, në të cilën MASHTI ka detyrim që të zvogëlojë numrin e agjencive ekzekutive për së paku një. Thjeshtësimi do të duhej të shoqërohej me një qartësim të funksioneve që do ketë agjencia e re, strukturën e saj që duhet të reflektojë një minimizim të burokracisë vendimmarrëse dhe një përshkrim të kompetencave në mënyrë të tillë që të mos lejojë dyfishim, paqartësi e as kompleksitet të pamenaxhueshëm në qarkun vendimmarrës. Themelimi i trupës së re duhet bërë në mënyrë të tillë që raporti i saj me MASHTI-n të jetë i qartë dhe të mos lejojë hapësirë për dykuptimësi në linjën e saj llogaridhënëse. Thjeshtësimi duhet të reflektohet edhe në ligjin përkatës që do të duhej të kodifikonte në tërësi materien e arsimit dhe aftësimit profesional sa i përket anës përmbajtësore të rregullimit por edhe asaj të menaxhimit institucional. Agjencia e re do t'i trashëgojë nëpunësit civil, dokumentet strategjike dhe kuadrin e përgjithshëm të memories institucionale të pararendësve të saj, AAAPRr-së dhe AKK-së. Po ashtu, sipas kornizës ligjore momentalisht në kuadër të sistemit kemi edhe trupat mbështetës, si KAAPARr, Këshillin drejtues të AKK-së si dhe Këshillin drejtues të AAAPARr-së, anëtarët e të cilëve përfaqësojnë institucione dhe partnerë social pothuajse të njëjtë. Në ligjin e ri gjithashtu do të parashihet ndarja e qartë e rolit ekzekutiv nga ai politikbërës, e ky i fundit do të mbetej kompetencë e departamentit përkatës të MASHTI-t. Agjencisë do t'i përcaktohen funksione, kompetenca dhe përgjegjësi për arsimin dhe aftësimin profesional, përfshirë: zbatimin e politikave të AAP-së, validim dhe akreditim te programeve dhe akreditimin e IAAP-ve të arsimit dhe aftësimit profesional në kuptim të AAPARr, rregullimin e kualifikimeve kombëtare përfshirë popullimin e KKK-së dhe zbatimin e strategjive në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional, avancimin e arsimit dhe aftësimit profesional dhe sigurimin e cilësisë. Po ashtu, agjencia merret me zhvillimin profesional të mësimdhënësve, përkrahjen dhe fuqizimin e IAAP-ve (planifikim te programeve, financimit, resurseve

**Commented [KB45]:** Konstatim qe nuk mendoj qe qendron. Cka konkretisht ne ligjet aktuale e ka bere te veshtire, difuz dhe te pakoordnuar zbatimin e ligjeve ne AAP? Duhet te ofrohen argumente qe mbeshtesin konstatime te tilla kaq te forta.

**Commented [KB46]:** Ne nje ligj te vetem? Tani ju lutem ta qartesoni, do te kete nje ligj per AAP, per te rritur dhe per kualifikimet, apo tri ligje te ndara?

**Commented [KB47]:** E paqarte, si qenkan ne forme paralele lidhjet me industrine aktualisht?

**Commented [KB48]:** Po perseritet vazhdimisht kjo, por askund nuk po argumentohet

**Commented [KB49]:** Nuk qendron kjo, nuk ka detyrime te tilla MASHTI. Ai ka qene rekomandim i racionalizimit te agjencive ne nivel te qeverise, kurrsesi detyrim.

**Commented [KB50]:** Kete do te duhej ta ofronte ky koncept dokument?

njerëzore, projekte ndërkombëtare), zhvillimin e kurrikulave, fuqizimin dhe promovimin e modaliteteve të mësuarit dual, për mësimin në vendin e punës, praktikave në kompani, praktikave profesionale etj, zbatimin e vlerësimeve të IAAP-ve. Fuqizimi i agjencisë do të bëhet përmes mekanizmave ligjor. MASHTI/DAAP janë institucione politikbërëse për hartimin e legjislacionit primar dhe sekondar, hartimin e strategjive, bashkëpunimin ndërkombëtar, etj. Përmes ligjit të ri do të parashihet themelimi i një trupe të pavarur, që reflekton përfaqësimin e tre palëve relevante për AAP-në, përkatësisht industritë, nxënësit dhe autoritetin publik, dhe e cila do të vishet me kompetencën për të akredituar institucionet arsimore të AAP-së, validuar programet dhe miratuar raportet e kontrollit të cilësisë e performancës së këtyre akterëve. Fuzionimi i tre mekanizmave në një trupë të vetme do duhej të bëhej në përputhje me parimet e acquis. Njëri nga parimet fundamentale të acquis në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional parauniversitar dhe atij për të rritur, është pavarësia e organit që ushtron kompetencën e akreditimin e IAAP-ve, validim të programeve të AAP-se. Një standard të tillë e garanton edhe Ligji për KKK aktualisht sa i përket mënyrës së funksionimit të AKK-së. Prandaj, do të parashihet në ligj që agjencia do të përmbajë një trupë kolektive vendimmarrëse me tiparet e AKK-së, e cila do të emërohet në një proces të konkurrimit publik dhe në garantim të standardeve të larta profesionale e cila do të gëzojë pavarësi të plotë vendimmarrëse sa i përket vendimeve meritore për akreditimin e IAAP-ve, validim të programeve të AAP-se . Vendimet e saj do jenë thellësisht të bazuara në përcaktimet strategjike të arsimit dhe aftësimit profesional dhe gjithashtu do të duhej të jenë të ndërlidhura me nevojat e industrive dhe të tregut të punës. Pavarësia e trupës së tillë do të sigurohet edhe përmes pamundësisë së shkarkimit të anëtarëve të saj, pos për arsye që lidhen me shkelje serioze të ligjit. Plotësim-ndryshimi i të tre ligjeve do të rezulton në një parashikim të qartë të një mekanizmi që e ndërlidh më përmbajtësisht institucionin dhe programin e AAP-së me nevojat e tregut të punës, për t'i dhënë kështu një dimension funksional ndërlidhjes së tillë. Përveç kësaj, rishikimi i të tre ligjeve do të rezulton në një hartë të thjeshtësuar institucionale, meqenëse do të fuzionohen Këshilli drejtues i AKK-së dhe Këshilli për arsimin dhe aftësimin profesional dhe për të rritur në një trupë të vetme. Karakteri këshillëdhënës i këtij trupe të re për MASHTI-n do të ridefinohet, duke e vendosur atë në qendrën që përfaqëson të tre palët e interesit për definimin e planifikimeve në fushën e AAP-së. Vendimet e saj do jenë thellësisht të bazuara në përcaktimet strategjike të arsimit dhe aftësimit profesional, gjithashtu do të duhej të jenë të ndërlidhura me nevojat e industrive dhe të tregut të punës. Në ligjet aktuale në fuqi, por edhe në dokumentet strategjike, ndërlidhja e programeve të arsimit dhe aftësimit profesional nuk e ka arritur qëllimin. Nuk ekziston një mekanizëm funksional që e bën një ndërlidhje të tillë sipas kritereve të nevojshëm për vlerësim të besueshëm. Ligji i ri do të parashikojë një mekanizëm funksional që mundëson ndërlidhje e kualifikimeve me nevojat e tregut/industrive. Një mekanizëm i tillë do të duhej të parashikonte rivlerësim periodik të programeve të IAAP-ve në mënyrë që të vlerësohen nëse ato të shërbejnë nevojave të tregut dhe industrive, reflektim pothuajse i plotë i vlerësimeve të operatorëve të tregut. Bazuar në një sistem të tillë, reformimi i kurrikulave do të iniciohej automatikisht në çdo rast kur konstatohet mungesë serioze e produktivitetit të të diplomuarve si rezultat i mungesës së shkathtësive dhe dijes së marrë në proces arsimor aftësimi profesional. Një qark i tillë i llogaridhënies duhet parashikuar në ligjin e ri, ashtu që t'i bëjë zyrtarisht bashkëhisedarë shoqatat e industrive, shoqatat e bizneseve, etj, në procesin e akreditimit, reformës dhe financimit të IAAP-ve. Krijimi i një mekanizmi mbikëqyrës duhet të rezultojë me ndryshime në qeverisjen e agjencisë, IAAP-ve, etj.

Në kuadër të këtij opsioni do të përmbushen edhe përcaktimet e Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027, në atë mënyrë që të digjitalizohen në maksimum procedurat e parashikuara në lidhje me licencimin, validimin dhe në përgjithësi sistemin e arsimit dhe

**Commented [KB51]:** Me larte u tha qe Ministria do te kete funksion vetem ne harim te legjislacionit, te karakterit ligj, duke lene te kuptohet qe aktet nenligjore mbeten pergjegjesi e Agjencise se re.

**Commented [KB52]:** Pra, Qendrat e Kompetences nuk do te menaxhohen tutje nga Agjencia. Kjo do te ishte shume e demshme per QK-te.

**Commented [KB53]:** Cilet mekanizma ligjor do ta fuqizojne agjencine, a mund te ofrohet nje permbledhje e shkurter e pergjithshme?

**Commented [KB54]:** Pra, nxenesit do te jene poashtu te perfaqesuar ne akreditim ne nivel te ofrueseve dhe kualifkimeve? A ka praktika te tilla?

**Commented [KB55]:** Mbi te gjitha duhet te bazohen ne kritere/standarde profesionale qe percaktohen ne ligj. Vendimet bazohen vetem ne kritere. Kriteret mund te reflektojne percaktimet strategjike te AAP-se, te cilat jane vazhdimisht dinamike.

**Commented [KB56]:** Cka kane penguar ligjet aktuale ne fuqi ne kete drejtim?

aftësimit profesional. Gjithashtu, të tre ligjet do të harmonizohen me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative (LPPA), në veçanti në kuptim të procedurave të veçanta administrative të këtyre ligjeve kundrejt LPPA, neneve: 12, 73.3, 86.3, 98 dhe 135, në rastet ku është relevante. Të tre projektligjet do të marrin parasysh të gjitha komponentët që ndërlidhen me zbatimin e politikave dhe praktikave të mira të fushës së inovacionit, digjitalizimit, ndërmarrësisë dhe agjendës së gjelbër.

Prandaj, opsioni i rekomanduar për MASHTI-n është opsioni 3, meqenëse vetëm ai ka kapacitetin për t'i adresuar objektivat në mënyrë të plotë dhe shteruese.

## Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

**Opsioni nr. 1**

*Figure 6: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit*

| **Ndikimet kryesore të pritshme** | |
|---|---|
| Ndikimet buxhetore | Zbatimi i konceptdokumentit sipas këtij opsioni nuk do të kishte ndikime buxhetore negative, megjithatë do të vazhdohej të financohej një sistem qeverisjeje i arsimit dhe aftësimit profesional që nuk është mjaftueshëm efikas për shpenzimin e parasë publike. |
